



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

VENDIM

Nr. 86 Datë 27.12.2024

PËR

**MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KUKËS
PËR VITIN 2025**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projektvendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtorisë së të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave, raportin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, si dhe bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nën 8/2, 9/1/1.3, 54/f, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, ligjin Nr.115/2014, të miratuar me datë 31.07.2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësisë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar), ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nën 4,5,7,10-20, ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006,” “Për Sistemin e Taksave Vendore”(i ndryshuar), nën 4,5,6,7,9,10,14,20-34,35, ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar), nën 2,6,7,40,68,69,76,106, ligjin Nr.29/2023, datë 30.03.2023” Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ligjin Nr.131/2015, të miratuar me datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ligjin Nr.10081, datë 23.02.2009 “Për Liçencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar), ligjin Nr.107/2014, të miratuar me datë 31.07.2014, “Për Planifikimin e Territorit”(i ndryshuar), nën 5,12,13,27,46, ligjin Nr.9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”(i ndryshuar), ligjin Nr.10465, datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar), ligjin 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ligjin Nr.9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”(i ndryshuar), ligjin Nr.9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” (i ndryshuar), ligjin 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” (i ndryshuar), ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”(i ndryshuar), ligjin Nr.119/2014, të miratuar me datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”(i ndryshuar), ligjin Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, VKM Nr.408, datë 13.05.2015, “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”(i ndryshuar), VKM Nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e

vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”,(i ndryshuar),VKM Nr.559 date 29.07.2022(i ndryshuar me VKM Nr.267 date 27.04.2023), “Per percaktimin e çmimit dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te Fondit Pyjor Kombetar per veprimtari ekonomike dhe prodhime drusore e jodrusore pyjore si dhe menyren e proçedures se mbledhjes se tyre”, VKM Nr.607 date 29.07.2020 “ Per tarifat per llojet e sherbimeve qe ofrohen nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”, udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013" Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël", (i ndryshuar), udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar), pas relacionit nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ku përfshihen edhe propozimet me shkrim të bëra nga drejtoritë e tjera në Bashki sipas funksioneve që ato kanë,

VENDOSI

1. Të miratojë taksat dhe tarifat vendore për Bashkinë Kukës për vitin 2025, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtorisë së të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

ALBERT MUJA

Shpallur me datë 27.12.2024

Vota Pro 20 Kundër 0 Abstenim 3





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E TE ARDHURAVE, PRONAVE PUBLIKE, LEJEVE DHE LICENCAVE

Nr. _____ Prot.

Kukës me, _____.2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. 67 Datë 12.12.2024

PËR

MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KUKËS PËR VITIN 2025

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015, te miratuar me date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.3, 54/f, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative ne RSH",ligjin Nr.115/2014, te miratuar me date 31.07.2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësite të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),ligjin Nr.68/2017, te miratuar me date 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"(i ndryshuar) nenet 4,5,7,10-20,ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006," "Për Sistemin e Taksave Vendore"(i ndryshuar),nenet 4,5,6,7,9,10,14,20-34,35,ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),nenet 2,6,7,40,68,69,76,106, ligjin Nr.29/2023, datë 30.03.2023" Për Tatimin mbi të Ardhurat" (i ndryshuar), ligjin Nr.131/2015, te miratuar me datë 26.11.2015 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ligjin Nr.10081,datë 23.02.2009 "Për Liçencat,Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), ligjin Nr.107/2014, te miratuar me datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e Territorit"(i ndryshuar),nenet 5,12,13,27,46,ligjin Nr.9482, datë 03.04.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje"(i ndryshuar),ligjin Nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), ligjin 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" (i ndryshuar), ligjin Nr.9385,date 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor"(i ndryshuar),ligjin Nr.9693,datë19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" (i ndryshuar),ligjin 24/2017 "Per administrimin e ujitjes dhe kullimit" (i ndryshuar), ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative"(i ndryshuar),ligjin Nr.119/2014, te miratuar me date 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"(i ndryshuar),ligjin Nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",ligjin Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik",VKM Nr.408, datë 13.05.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"(i ndryshuar),VKM Nr.132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa",(i ndryshuar),VKM Nr.559 date 29.07.2022(i ndryshuar me VKM Nr.267 date 27.04.2023), "Per percaktimin e çmimit dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te Fondit Pyjor Kombetar per veprimtari ekonomike dhe prodhime drusore e jodrusore pyjore si dhe menyren e proçedures se mbledhjes se tyre", VKM Nr.607 date 29.07.2020 " Per tarifat per llojet e sherbimeve qe ofrohen nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi", udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013"Për Tatimin

e Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël", (i ndryshuar), udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), pas relacionit nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ku përfshihen edhe propozimet me shkrim të bëra nga drejtoritë e tjera në Bashki sipas funksioneve që ato kanë, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Kukes te,

MIRATOJE:

1. Taksat dhe tarifat vendore për Bashkinë Kukes për vitin 2025, bashkangjitur këtij P/vendimi

KRYETARI

ALBERT HAHILAJ



Konc. P.Guri

Ligjshmeria: E.Kerxhaliu

Sekretari: E.Ramallari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

PËR

MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KUKËS PËR VITIN 2025

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015, te miratuar me date 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore", ligjin Nr.44/2015, te miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative ne RSH", ligjin Nr.115/2014, te miratuar me date 31.07.2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), ligjin Nr.68/2017, te miratuar me date 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar),....., bashkangjitur ketij Relacioni ju paraqesim P/Vendimin:

"Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore ne Bashkine Kukes per vitin 2025"

Hyrje

Autonomia fiskale, u garanton njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtën për të vendosur e mbledhur taksa dhe tarifa vendore ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 (i ndryshuar). Çdo njesi e vetëqeverisjes vendore, synon ne drejtim te krijimiti te burimeve financiare të nevojshme, për realizimin e funksioneve të saj.

Taksat dhe tarifat vendore, përbëjnë një burim të rëndësishëm financiar të buxhetit të pushtetit vendor. Reforma e decentralizimit ka bërë që shumë kompetenca dhe funksione të pushtetit qendror, të transferohen në pushtetin vendor. Ky transferim, është shoqëruar me mjetet e nevojshme financiare nga buxheti i shtetit, ose me të drejtën për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore.

Në Republikën e Shqipërisë sistemi i taksave përbëhet nga dy nivele: Taksat Kombëtare dhe Taksa vendore të cilat rregullohen nga legjislacioni përkatës.

Të ardhurat e veta, të bashkive, krijohen kryesisht nga taksat dhe tarifat vendore, për të cilat njësitë vendore kanë autoritet të plotë ligjor, për të vendosur nivelin e taksës mbi atë orientues, ose tregues i cili përcaktohet me ligj.

Modalitetet për ndryshimin e nivelit të taksës, përcaktimin e mënyrës së mbledhjes se tyre, etj., janë të percaktuara në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" me amendimet përkatëse dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Niveli tregues i taksës se biznesit:

Nivelet treguese të taksës vendore, të pasqyruara ne anekset e ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar”, janë orientuese. Shuma faktike e detyrimit për t’u paguar, për çdo kategori biznesi, përcaktohet nga këshilli bashkiak.

Këshilli Bashkiak, mund të ndryshojë nivelin orientues të taksës, të përcaktuar në aneksin 5, në nivelet + 10 për qind / - 30 për qind.

Per shkak te situates social-ekonomike, nuk ka ndryshim te kategorive te taksave dhe tarifave vendore, duke ruajtur nivelin e miratur ne vendimin e Keshillit Bashkiak Kukes Nr.68, date 22.12.2023.

Përcaktimi i vendndodhjes së biznesit dhe kërkesat për regjistrim:

Tatimpaguesit i kërkohet të paguajë taksën vendore, për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin tatimor të përcaktuar për llojin e biznesit dhe kategorinë e zonës gjeografike, ku ai është regjistruar. Një “**Vendndodhje biznesi**” është një zonë e dallueshme dhe e ndarë, si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme.

Konsultimi me qytetarët dhe grupet interesit

Në hartimin e draft/paketës fiskale të Bashkisë Kukës, u përfshinë institucionet shtetërore, njesite administrative, përfaqësues të biznesit si dhe aktore të tjera. Ne kete kuader, me date 06.12.2024 Bashkia Kukes organizoi degjese publike per prezantimin e paketes fiskale per vitin 2025.

Zbatimi i paketes fiskale:

Administrata tatimore e qeverisjes vendore, ka të njëjtat detyra dhe të drejta, me administratën tatimore të pushtetit qendror. E gjithë procedura, e mbledhjes dhe administrimit të taksave dhe tarifave vendore, mbështetet ne ligjin Nr.9632, date 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, me amendimet përkatëse, si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar)

I.KATEGORITE E TAKSAVE VENDORE:

Në taksat vendore përfshihen:

- a. Taksa vendore mbi biznesin e vogël;
- b. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, (taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore);
- c. Taksa e fjetjes në hotel;
- d. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
- e. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- f. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve;
- g. Taksa për zënien e hapësirave publike;
 - a. Taksa e tabelës;
 - b. Taksa të përkohshme.

Taksat mbi pronat e paluajtshme:

Taksa mbi ndërtesën dhe taksa mbi tokën bujqësore, përfaqësojnë dy taksat vendore mbi pronat e paluajtshme. Këto taksa aplikohen mbi të gjithë individët ose subjektet fizike e juridike, të cilët janë pronarë të një ndërtese dhe/ose të një sipërfaqe toke, e klasifikuar kjo si tokë bujqësore. Planifikimi, llogaritja dhe mbledhja e këtyre taksave rregullohet sipas përcaktimeve në ligjin Nr.9632, date 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar).

Taksa mbi ndërtesat:

Baza e taksës mbi ndërtesat është *“sipërfaqja e ndërtimit në metër katror”* e ndërtesës, ose pjesës së saj mbi dhe, në nivelin e tokës dhe për çdo kat. Në zbatim të pikës 1 të nenit 22 të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)*, sipërfaqe ndërtimi do të konsiderohet çdo sipërfaqe pavarësisht nga pozicioni vertikal (poshtë apo lart) në raport me truallin mbi të cilin është ndërtuar.

Në bazë të VKM Nr.132, datë 07.03.2018, është miratuar metodologjia për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme *“ndërtesë”*

Taksa mbi tokën bujqësore

Në bazë të nenit 23, të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)*, baza e taksës, është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar, në pronësi të tatimpaguesit.

- Taksapagues i taksës mbi tokën bujqësore, është çdo individ, person fizik, juridik vendas dhe i huaj që ka në pronësi tokë bujqësore.
- Këshilli Bashkiak, ka të drejtë të miratojë nivelin e taksës mbi tokën bujqësore +/- 30 për qind të nivelit tregues të kësaj takse të dhënë në Aneksin Nr.2, të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)*
- Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit Nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Taksa mbi truallin

Truall është një sipërfaqe toke, jo-bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Taksa e fjetjes në hotel

Sipas nenit 26 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)*, me hotel, do të kuptohet: *“Çdo veprimtari që jep strehim, kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër, që përdoret për këtë qëllim”*.

- Baza e taksës së fjetjes, në hotel, është çmimi i fjetjes për dhomë ose për person në një natë. Kjo taksë është për fjetjet në hotel si të personave me shtetësi shqiptare ashtu dhe për personat me shtetësi të huaj.
- Sipas ligjit, Këshilli Bashkiak vendos për nivelin e kësaj takse, deri në 5 për qind të çmimit të fjetjes. Bashkia në fillim të çdo viti fiskal, njofton të gjithë personat fizik, ose juridik që ushtrojnë aktivitetin e hotelierisë, për kategorinë e hotelit (sipas klasifikimit të bërë nga Këshilli) dhe nivelin e taksës së fjetjes, në hotel.
- Derdhja e kësaj takse, bëhet çdo datë 5, të muajit pasardhës. Në fund të çdo muaji, bëhet një akt-rakordim midis pronarit të hotelit, ose të autorizuarit të tij dhe përfaqësuesit të NJQV-së.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Sipas nenit 27 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, *“Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)*, baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri. Për efekt të përlogaritjes së kësaj takse, shërben preventivi i investimit.

a). Niveli i taksës shprehet në përqindje ndaj vlerës së investimit. Niveli i taksës është:

- Për leje ndërtimi për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim public, kemi propozuar kete takse ne 6% të çmimit të shitjes.
- Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në piken 1, më lart, kemi propozuar kete takse ne 2.5 % e vleres investimit.
- Leje ndërtimi për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, kemi propozuar kete takse ne 0.1 % të çmimit të shitjes.
- Ndersa për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, ne masen 0.5 %

b).Këshilli Bashkiak, ka të drejtë që brenda këtyre kufijve te percaktuar ne ligj, të miratojë nivelin e kësaj takse, si dhe kategoritë dhe nënkategoritë, për klasifikimin e investimeve të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit te taksës.

Taksa e kalimit te drejtës se pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat, është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

- Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 të ligjit Nr.9632, date 30.10.2006. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës.
- Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme, është vlera e shitjes së tyre.
- Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind.
- Vjelja e taksës së kalimit të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, bëhet nga ASHK

Taksa e tabelës

Baza e taksës së tabelës, mund të jetë sipërfaqja e saj, ose tabela e standardizuar, ku si bazë shërben numri i tyre. Kategoritë e bazës së taksës së tabelës dhe niveli i tyre jepen në aneksin, që i bashkëlidhet paketës fiskale.

Përfshirjet:

Në bazë të nenit 6 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), subjektet e parashikuara me ligje të veçanta, përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Për këtë, të gjithë invalidët e punës, veteranët e luftës kundër pushtuesve, të verbrit, invalidët paraplegjike dhe tetraplegjike duhet detyrimisht të paraqesin pranë autoriteteve të pushtetit vendor dëshmitë e statusit përkatëse (që e fitojnë në bazë të ligjit Nr.7874, datë 17.11.1994, “Për Statusin e Veteranit te Luftës kundër pushtuesit nazifashist të popullit shqiptar”, (i ndryshuar), ligjit Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, dhe ligjit Nr.7889, date 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”).

Këshilli Bashkiak vendos për lehtësimin, ose përjashtimin nga taksa, të personave nën minimumin jetik, bazuar në kriteret kombëtare të vlerësimit të këtij minimumi, si dhe personave që ju dëmtohet pasuria nga forca madhore në përputhje me ligjin.

Taksa te perkohshme:

Nje nga taksat me karakter te perkohshem, e perfshire ne draft/paketn fiskale te vitit 2025, eshte dhe taksa per linjat ajrore dhe nentokesore (rrjete infrastrukturore kablllore nentokesor dhe mbi tokesor)

Baza e takses për linjat ajrore dhe nentokesore është gjatësia lineare për ml e linjave ajrore dhe nentokesore e cila vihet në shprehje nga subjektet për qëllim biznesi.
Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për meter linear) me nivelin tregues të saj.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Kukës:

- a) Takse për përdorimin e rrjetit infrastrukturor kabllor nentokesor 60 leke/ml/vit
- b) Takse për përdorimin e rrjetit infrastrukturor kabllor mbitokesor 40 leke/ml/vit

Niveli i kësaj takse është, për arsye të zhvillimit të infrastruktures së kanaleve kabllore nentokesore, si dhe shtimit të kërkesave nga operatorët ekonomik, ku si rezultat i nderhyrjeve në sistemin e infrastruktures publike për shtrirjen dhe ndërtimin e rrjeteve kabllore, ka një rritje të kostos së shërbimit të mirëmbajtjes për shkak të demtimit të rrugeve, shesheve, trotuareve, etj.

II. TARIFAT VENDORE

“Tarifë vendore” është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejta të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

Sipas nenit 5 të ligjit Nr.10/117, datë 23.04.2009, përcaktohet se: *“Tarifat, vendosen dhe administrohen, në përputhje me ligjin”*.

Këshilli i NJQV-së, vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake, apo nga një agjent,

Keto tarifa janë vendosur në përputhje me përmbajtjen e nenit 17 të ligjit Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” që shprehet se:

- *Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribuueshëm për aktivitetin në fjalë.*

2. Gjithashtu nuk ka ndryshim tek tarifat e përcaktuara në pikën II.11. (Tarifa shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social).

- Në bazë të VKM Nr.323, datë 14.6.1993, institucionet fëmimore (çerdhet) kanë kaluar në administrim të organeve të pushtetit lokal, bashkive, sipas juridiksionit.
- Ndërsa në bazë të VKM Nr.502, datë 16.04.2008 “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” (i ndryshuar), njësive vendore u ka kaluar funksioni i administrimit të konvikteve.

Për arsye të gjendjes social-ekonomike, Bashkia Kukës nuk do të ndryshojë nivelin e kuotes financiare për institucionet e mesiperme, pasi rritja që vjen si pasoje e ndryshimit të normes ushqimore do të perballohet nga rritja e taksave dhe tarifave të tjera vendore.

Për vitin fiskal 2025, Bashkia Kukës si autoritet vendor, ka si objektiv ngritjen dhe funksionimin e sistemit elektronik të detyrimeve vendore.

III. Analiza e riskut:

1. Ne percaktimin e zerave, kategorive, nivelit te taksave dhe tarifave vendore, eshte marre ne konsiderate dhe analiza e riskut ne menyre qe te percaktohen ato elemente negativ te cilet mund te ndikojne ne mos realizimin e te ardhurave ne perputhje me planin e miratuar. Ne kete drejtim jane marre ne konsiderate elementet e meposhtem:

- Evidentimin e bizneseve të peregjistruara dhe detyrimin e tyre për tu regjistruar;
- Dhënien e informacionit periodik nga QKR-ja, pushtetit vendor, në lidhje me regjistrimin dhe çregjistrimin e bizneseve;
- Përmirësimin e metodave dhe procedurave për mbledhjen e taksave & tarifave vendore;
- Investimet në modernizimin e mbledhjes së taksave vendore nëpërmjet programeve dhe softeve të ndryshme perben një tjetër sfidë për pushtetin vendor;
- Lidhja e politikave fiskale vendore me ato zhvillimore përsa i perket rishikimit te bazës së të ardhurave.

Sa me siper, i propozojme Keshillit Bashkiak Kukes qe te miratoje paketen fiskale (taksa & tarifa vendore) per vitin 2025

Ju faleminderit !

DREJTORI
Perparim GURI



Kukes me, 11.12.2024

PAKETA FISKALE 2025

“Për një qeverisje vendore që synon të rrisë kapacitetet fiskale dhe administrative për realizimin e funksioneve në përgjegjësinë e saj”

A. Mbi Bashkinë Kukës

Bashkia Kukës (BK) me qendër qytetin e Kukësit, ndodhet në Veri-Lindje të Republikës së Shqipërisë me një shtrirje gjeografike vetëm 3.2%¹ të sipërfaqes totale të vëndit.

Bashkia e Kukësit ndodhet në kufi me Komunën e Prizrenit (Kosovë) dhe është një pikë qendrore ekonomike për doganën e Morinës. Në brendësi të territorit shqiptar kufizohet me Bashkinë e Peshkopisë në jug, Bashkinë e Fushë Aresit në perëndim dhe Bashkinë e Hasit në veri. Qyteti i Kukësit është edhe qendra administrative e Bashkisë së Kukësit.

Krijuar menjëherë në juglindje të Malit Gjallica, ndërsa në perëndim gjendet në një lartësi të butë kodrinore natyrore me lartësi 600-800 m. Në pjesën juglindore ku qëndron Qyteti i Ri i Kukësit, më saktë nga Mali Gjallica, dalin Gryka e Vanave dhe Kanioni i Bicajve.

Relievi i territorit të Bashkisë Kukës është kryesisht malor. Në këtë zonë shtrihet Mali i Gjallicës dhe Mali i Koritnikut (2,393 m), të cilat janë pjesë e Vargmalit të Korabit si dhe Lugina e Drinit e cila dallohet për relievin shumë të ashpër dhe grykat e ngushta, në të cilat janë ndërtuar digat e hidrocentraleve të mëdha. Shtrirja e një pjese të Vargmalit të Korabit në këtë zonë thekson karakteristikën e saj si zonë malore, ku vendbanimet arrijnë deri në rreth 1400 m lartësi.

Në këtë zonë shtrihet një pjesë e liqenit të Fierzës, i cili është liqeni më i madh artificial në Shqipëri. Gryka e Morinit, nëpër të cilën kalon rruga për në Prizren, e bën këtë zonë një nyje lidhëse me Kosovën.



Konteksti i ri i Bashkisë Kukës paraqet jo vetëm zgjerim gjeografik të kufijve administrativë, por edhe shumëllojshmëri të territorit. Bashkia mbulon tashmë teritore të pesë bashkive administrative: Kukës, Shishtavec, Bicaj, Ujmisht, Arren, Terthore, Zapod, Gryke-Çaje, Malzi, Kalis, Surroj, Kolsh, Bushtrice, Shtiqen dhe Topojan ku janë të përfshira 87 fshatra.

Secili nga këto territore ka ndërthurjen e vet të traditave, burimeve natyrore, burimeve ekonomike e cilësive infrastrukturore. Bazuar në politikat zhvillimore të territorit të Bashkisë Kukes, *veprimet tona duhet t'i japin vlerë zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe traditave tona kulturore. Ndaj çështja kryesore është gjetja e mundësive që të kthejmë këtë shumëllojshmëri në avantazh konkurrues dhe çdo territor të kontribuojë në mirëqenien e Bashkisë.*

Për të krijuar këtë mjedis, ne do fokusojmë punën në përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, fizike dhe financiare.

Sipas Ligjit Nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) Njësi Administrative Kukes quhet zona urbane që zinte Bashkia Kukes përpara ndarjes së re territoriale.

Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës Nr.1, të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

Tabela 1: Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Kukes

Nr	Njësi Administrative	Lagje / Fshatra
1	Kukes	Lgj.Nr. 1, Lgj. Nr 2 Lgj.Nr 3 Lgj.Nr.4 Lgj.Nr 5 Lgj.Nr 6 Lgj.Nr. 7 Lgj. e Re , Parku Ri Drinas Gostili.
2	Njesia administrative Shishtavec.	Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Oreshke, Cernaleve, Shtreze.
3	Njesia administrative Bicaj.	Bushat, Osmanaj, Bicaj, Muhole, Mustafaj, Kolesjan, Nange, Domaj, Gabrrice, Tershene.
4	Njesia administrative Ujmisht	Lusen, Zall-Lusen, Malqene, Ujmisht, Resk, Tejdrine.
5	Njesia administrative Arren	Arren, Verrij, Arrez, Barre, Tejmalles.
6	Njesia administrative Terthore	Morin, Bardhoc i ri, Bardhoc qe, Gjeggjan, Pobreg, Breg-lume.
7	Njesia administrative Zapod	Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orçikel, Bele, Lojme.
8	Njesia administrative Gryke-Qaje	Çaje, Shkinak, Fshat, Buzmadhe.
9	Njesia administrative Malzi	Shemri, Petkaj, Mgulle, Qam, Gdheshte,Piste, Simon, Kalimash, Dukagjin,Shikaj, Kryemadh, Shtane.
10	Njesia administrative Kalis	Kalis,K/Geshtenje,Gurre,Geshtenje,Pralisht
11	Njesia administrative Surroj	Qinamake,Surroj,Fushar,Aliaj
12	Njesia administrative Kolsh	Kolsh,Mamez,Myç-Mamez
13	Njesia administrative Bushtrice	Bushtrice,Palush,Matranxh,Gjeggjan,Vile,Barruc,Shpat
14	Njesia administrative Shtiqen	Shtiqen,Muje,Gjallice,Koder-Lume,Krenxe
15	Njesia administrative Topojan	Topojan,Brekije,Xhaferraj,Turaj,Nimce

A.1 Proçesi i Hartimit të Paketës fiskale

Pas bashkimit të menjëhershëm të 15(pesembëdhjetë) njësive të qeverisjes vendore, Bashkia e Kukësit u ballafaqua me nevojën e hartimit të një pakete fiskale të integruar dhe të aplikueshme në të gjithë territorin.

Nga analiza e dokumentave vendorë janë evidentuar probleme që lidhen me:

- Aplikimin e niveleve të ndryshme të pa studiara, të taksave dhe tarifave vendore, në njësi të ndryshme;
- Referencë dhe aplikim jo i duhur i bazës ligjore;
- Mungesë analize dhe plani menaxhimi për shërbimet publike (mbledhja-grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane, ndriçimi rrugor, gjelbërim, mirëmbajtje infrastrukturë rrugore, mirëmbajtje rrugë rurale, ofrimi dhe menaxhimi i shërbimit me ujë të pijshëm, mirëmbajtje objekte të arsimit parashkollor, mirëmbajtje të objekteve të arsimit, mirëmbajtje të objekteve në shërbimin shëndetësor, etj.);
- Mungesë e analizës së kostove sipas standarteve për shërbimet publike;
- Mungesë e bazës së të dhënave për bizneset;
- Mungesë e bazës së të dhënave për familjet dhe individët;
- Mungesë e bazës së të dhënave për ndërtesat;
- Mungesë e bazës së të dhënave për tokën bujqësore;
- Mungesë e një plani për zënien e hapësirës publike;
- Mungesë e një plani për parkimin publik;

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Kukës

- Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
- Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.
- Drejtoria e Shërbimeve Komunitare.
- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.
- Drejtoria e ndihmes ekonomike dhe shërbimeve sociale.
- Drejtoria e Arsimit, Kultures, Sportit dhe Rinisë.
- Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.
- Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe IT.
- Administratorët e njësive administrative.

A.2 Çfarë prezanton paketa fiskale?

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore. Kjo qasje bazohet në përforcimin e identitetit të secilës zone të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës.

Miradministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave përbën moton e punës tonë.

Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara.

Ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuar në planin tona strategjike më afatgjatë.

Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, mbetet pikë kyçe e suksesit jo vetëm në hartimin e kësaj pakete por sidomos për zbatimin e saj.

Nga analiza e ecursisë së realizimit të të ardhurave të deritanishme rezulton se ka burime akoma të pashfrytëzuara në kapacitetet optimale. Kjo vërehet pothuaj në të gjitha njësitë administrative.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, ju paraqesim propozimet tona për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim të prioritetëve të strategjisë së Bashkisë së Kukësit.

Propozimet janë në përputhje me ndryshimet ligjore të ndodhura. Ato konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, duke patur parasysh që është hera e parë e përgatitjes së një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimine një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimine kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimine procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësi për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimine qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
 - ✓ Taksim i drejtë;
 - ✓ Tarifim mbështetur në kosto;
 - ✓ Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
 - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;
- h) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;
- i) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;
- j) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;
- k) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

A.3 Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar), përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” dhe ligjin Nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, (i ndryshuar), në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e pasurisë;
- ✓ Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- ✓ Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- ✓ Taksa e zënies së hapësirave publike;
- ✓ Taksa e tabelës/reklamat;
- ✓ Taksa të përkohshme;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmblëdhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Baza ligjore:

- ✓ Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me ligjin Nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr.142/2015, datë 17.12.2015, vendimin e Gjykes Kushtetuese nr.16,datë 1.3.2017,ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 dhe ligjin nr.106, datë 30.11.2017, nr. 41/2018, datë 9.7.2018, nr. 95/2018, datë 3.12.2018, ndryshuar me aktin normativ nr.3, datë 2.10.2019, me aktin normativ nr. 11, datë 27.3.2020, ligjin nr. 98/2020, datë 23.7.2020, nr. 122/2020, datë 15.10.2020, ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023: nr. 67/2023, datë 21.7.2023;
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*" (i ndryshuar)
- ✓ Ligji Nr.29/2023, datë 30.03.2023, "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar. ndryshuar me ligjin Nr. 9483, datë 16.2.2006, ndryshuar me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me ligjin Nr.9716, datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr.9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligjin Nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me ligjin Nr.9804, datë 13.09.2007; ndryshuar me ligjin Nr.9844, datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin Nr.10072,datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin Nr.10228,datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin Nr.10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin Nr.10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin Nr.71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr.122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin Nr.107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr.177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr.32/2014, datë 03.04.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin Nr.156/2014, dt. 27.11.2014;
- ✓ Ligji Nr.131/2015, datë 26.11.2015 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*";
- ✓ Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", (i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr.10081, datë 23.2.2009, "*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr. 10304, datë 15.7.2010, "*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*";
- ✓ Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, datë 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 dt. 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin Nr.10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin Nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011. ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012. ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2013, datë 18.04.2013. ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013. ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr.157/2014, datë 27.11.2014;
- ✓ Ligji Nr. 93/2015 "*Për turizmin*";
- ✓ Ligji Nr.9482, datë 03.04.2006 "*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*", (i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"(i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr 111/2018, i miratuar me date 07.02.2019 "*Për Kadastrën*";
- ✓ Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*";
- ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*", (i ndryshuar);
- ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*"(i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 "*Për fondin kullosor*", i ndryshuar(i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*";
- ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe Ligjin Nr.9797, datë 23.7.2007;
- ✓ Ligji Nr.69/2012, te miratuar me date 21.06.2012 "*Per sistemin arsimor parauniversitar ne Republiken e Shqiperise*"(te ndryshuar)
- ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"(i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr.10463, datë 22.9.2011, "*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*", (i ndryshuar);
- ✓ Ligji Nr.152/2015, datë 21.12.2015, "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*";
- ✓ Ligji Nr. 9789 date 19.7.2007 "*Per krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike*".

- ✓ Ligji Nr.68/2017, i miratuar me date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- ✓ Ligji nr. 106, datë 30.11.2017 “**LIGJ. Nr. 106/2017. PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR. SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR.**” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 222, datë 19 janar 2017 dhe hyn në fuqi më 1 prill 2018, me përjashtim të nenit 7, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2018.
- ✓ Ligji nr. 41/2018, datë 9.7.2018 “PËR NJË SHITESË NË **LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E. TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 111, datë 30 korrik 2018 dhe hyn në fuqi ne 1 janar 2019.

Vendime:

- ✓ VKM Nr. 783, datë 10.11.2011, “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”;
- ✓ VKM Nr.7, datë 4.01.2012, “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” ; (i ndryshuar)
- ✓ VKM Nr.396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”;
- ✓ VKM Nr.267 datë 27.04.2023 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”(i ndryshuar);
- ✓ VKM Nr.632 datë 11.06.2009 “Për tarifën në sektorin e Kullotave”,
- ✓ VKM Nr.1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 267 datë 27.04.2023 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;
- ✓ VKM Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr.992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.469, datë 3.6.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”;
- ✓ VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- ✓ VKM Nr.607, date 29.7.2020 “Për tarifën e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”;
- ✓ VKM Nr.1108, date 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;
- ✓ VKM Nr.666, date 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” (i ndryshuar)
- ✓ VKM Nr.323, datë 14.6.1993 “Per kalimin e institucioneve femine (çerdheve) ne administrim te pushtetit lokal”;
- ✓ VKM Nr.132, date 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”
- ✓ VKM nr. 783 date 10.11.2011 “Per procedurat e ndarjes se te ardhurave te takses vjetore te perdorura me njesite vendore”.

Udhëzime

- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”;

- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore";
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 "Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar;
- ✓ Udhëzim Nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", (i ndryshuar),
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çeshtjet Vendore Nr.541/1, datë 31.12.2015 "Udhëzues për zbatimin e VKM Nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme";

B. Paketa Fiskale

Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

I.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendasosë të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

1. Taksa mbi ndërtesat

Vlera e taksës për t'u paguar për çdo njësi pronësore llogaritet si shumëzim i bazës së taksueshme me shkallën e taksës. Baza e taksueshme është vlera e pasurisë, e cila llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtimit në metër katror.

2.1. Shkalla e taksës së ndërtesës/njesisë pronësore

Shkallanë përqindje e taksës mbi ndërtesën/njësinë pronësore, në përputhje me kriterete përcaktuara në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar)si dhe në VKM Nr.132, date 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” janë si më poshtë vijon:

- 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;**
- 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;**

- c. **30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.**

Bazuar në VKM Nr.132, datë 07.03.2018, neni 2, pika 3, paragrafi i parë, në të cilin parashikohet se: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind”, miratohen ndryshimet e niveleve të taksës sipas zonave si më poshtë:

Tabela 1: Shkalla e taksës e miratuar

Njësia Administrative/ Zona fiskale	Shkalla e taksës për ndërtesën/njësine pronësore që përdoret/shfrytëzohet për:					
	Banim			Veprimtari ekonomike		
	Shkalla e taksës sipas VKM Nr.132	Ndryshimi i shkallës së taksës i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar	Shkalla e taksës sipas VKM 132	Ndryshimi i shkallës së taksës i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar
Njesia Administrative Bashkia Kukes	0,05%	-30%	0.035%	0,2%	-30%	0.14 %
Njesit Administrative Ish Komunat	0,05%	-30%	0.035 %	0,2%	-30%	0.14%
Emërtimi	0,05%	-30%	0.035%	0,2%	-30%	0.14%

Çdo ndryshim i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak për shkallën e taksës siç është paraqitur në tabelën 1 më sipër, aplikohet edhe për ndërtesat për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

2.2. Ndryshimet e miratuara të çmimeve mesatare referuese

Në VKM Nr.132 datë 7.3.2018, neni 2, pika 3, paragrafi i dytë parashikon se: “Këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë, ky reduktim është deri në 30 (tridhjetë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale”. Bazuar në sa më sipër miratohen reduktimet e çmimeve referuese si më poshtë:

Tabela 2: Ndryshimet e miratura të çmimeve mesatare referuese

Njësia Administrative	Çmimi mesatar referues sipas VKM 132	Ndryshimi i miratuar i çmimit mesatar referues	Çmimi i miratuar
Emërtimi	Çmimi referues sipas VKM 132	____%	54000 Lekë
Emërtimi	Çmimi referues sipas VKM 132	____%	54000Lekë
Emërtimi	Çmimi referues sipas VKM 132	____%	____Lekë

2.3. Koeficientët e aplikuar mbi çmimet mesatare referuese për qëllim banimi sipas kategorive të përdorimit

Aplikohen koeficientët si më poshtë:

- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesat tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose /edhe shërbime me pakicë.
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.
- Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
- Për ndërtesat e privatizuara me ligjin Nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, (i ndryshuar), çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

2. Përjashtime

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë përdoren nga Bashkia si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet nga pensionistë të vetëm, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohej mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.

3. Detyrimi për pagesë

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është detyrim vjetor. [Njësia Përgjegjëse] kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Për katëgorinë “taksa e ndërtesës” për familjet paguhet nga të gjithë familjet e regjistruara në regjistrin e gjendjes civile të Bashkisë Kukes si dhe ata familje që janë banor por pa leje banimi të evidentura sipas rasteve.

Çdo poseduespasurie(*kategoria familjare*)duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë mbi pasurinë që zotëron, në të kundërt pagesa do llogaritet duke marrë për bazë sipërfaqen prej **100 m2**

*Për të vijuar puna për mbledhjen e taksës së ndërtesës për kategorinë **familjare** deri kur të përditësohen të dhënat e regjistrit qëndror të pasurive të paluajtshme (kadastra fiskale) siç e parashikon ligji do të paguhet në vlerën fikse vjetore **100 m2 për çdo familje**.. Pastaj do bëhet rakordimi i pagesave +/- për diferencën.*

4. Struktura për vjeljen e taksës për katëgorinë Ndërtesa është Drejtoria e Te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ne bashkëpunim me, Drejtoritë e tjera si dhe njesite administrative.

I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: “Tokë bujqësore” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Tabelë 1. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore	
		Sipas ligjit	Propozimi
I	lekë/ha/vit	4,200	1400
II	lekë/ha/vit	3,500	1200
III	lekë/ha/vit	2,800	1100
IV	lekë/ha/vit	2,300	1000
V	lekë/ha/vit	1,900	900
VI	lekë/ha/vit	1,600	800
VII – X	lekë/ha/vit	1,400	700

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe për familjarët shlyhet në bazë vjetore dhe mbledhet nga ne cdo njesi administrative.

1.Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e taksës bujqësore²:

- Familjet që kanë k/familjarin invalid të punës, invalide të luftës.
- Familje që kanë k/familjarin veteran luftë dhe familjet e “Deshmoreve të Atdheut”.
- Familje që kanë në perberje të tyre të verber, të semurë paraplegjike, tetraplegjike.
- tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Për kategoritë a,b,c përjashtohen vetëm nga taksa familjare dhe jo në rastin kur janë të regjistruar si subjekte ekonomike.

Shenim: Për të përfituar nga përjashtimi këto familje duhet të dorzojnë në Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pranë Bashkisë Kukes, dokumentat e mëposhtme:
-Librezën perkatese.

2.Menyrat e Pageses:

- Detyrimi për taksën mbi ndertësinë është vjetor.
- Për të gjitha kategoritë ky detyrim do të paguhet me 1 (një) kesht.
- Afati i pagesës është 20 prill.
- Afati pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

²Subjektet paraqesin pranë drejtorisë së të ardhurave, pranë Bashkisë Kukes, dokumentin justifikues të aktivitetit.

3.Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- Strukturat e ngarkuara për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për të gjitha kategoritë është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave prane Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit Territorial.
- Për njesitë administrative mbledhja e kësaj takse do të bëhet nga specialisti i ngarkuar në bashkëpunim me Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.
- Ngarkohet Sektori i Pronave dhe Hartografisë për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave duke pasqyruar dhe ndryshimet e herepashershme.
- Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e MBZHRAU.

1.2.3 Taksa mbi truallin

Përkufizimi: Truall është një sipërfaqe toke, jo-bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 2. Niveli i taksës mbi truallin

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin	
		Sipas ligjit i	Propozim
Për qëllime banimi nga individët	lekë/m ² /vit	0.14	0.14
Për qëllime biznesi	lekë/m ² /vit	12	12

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

1.Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e taksës mbi truallin³:

- Familjet që kanë k/familjarin invalid të punës, invalide të luftës.
- Familje që kanë k/familjarin veteran luftë dhe familjet e “Deshmoreve të Atdheut”.
- Familje që kanë në perberje të tyre të verber, të semurë paraplegjike, tetraplegjike.
- tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Për kategoritë a,b,c përjashtohen vetëm nga taksa familjare dhe jo në rastin kur janë të regjistruar si subjekte ekonomike.

Shenim: Për të përfituar nga përjashtimi këto familje duhet të dorzojnë në Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pranë bashkisë Kukës dokumentat e mëposhtme:
-Librezën perkatese.

2.Menyrat e Pageses:

³Subjektet paraqesin pranë Drejtorisë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, dokumentin justifikues.

- a. Detyrimi për takson mbi truallin është vjetor.
- b. Për të gjitha kategoritë ky detyrim do të paguhet me 1 (nje) kest

3.Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- a. Strukturat e ngarkuara për vjeljen e takse mbi ndërtesat për të gjitha kategoritë është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pranë Bashkisë Kukës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit Territorial.
- b. Për njesitë administrative mbledhja e kësaj takse do të bëhet nga specialisti i ngarkuar në bashkëpunim me Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave.

I.3. Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë”Standard, “Fjetinë”Standard, Komfort; “Kamping”Standard, “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Motel”Standard, Komfort, Superior; “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B)Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabelë 3. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel 4-5 yje	lekë/natë qëndrimi/për person	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për takson llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

2.Menyrat e Pageses:

- a. Detyrimi për takson i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- b. Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

3.Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- a. Struktura e ngarkuar për vjeljen e “taksës të fjetjes në hotel” për të gjitha kategoritë është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pranë Bashkisë Kukës.

I.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohej të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Tabela 6: Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë për vitin 2025

Nr.	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë	
		Sipas ligjit	Propozohet
		Në % të çmimit të shitjes për m ² .	Në % të çmimit të shitjes për m ² .
1.	Për leje ndërtimi për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.	4-8 % të çmimit të shitjes	6% të çmimit të shitjes
2.	Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në piken 1, më lart.	1-3 % të vlerës së investimit	2.5% të vlerës së investimit
3.	Leje ndërtimi për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1 % të vlerës së investimit por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	0.1 %
4.	Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0.5	0.5 %

Detyrimi për pagesën e taksës:

- a. Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksa për çdo rast mbledhet nga organi që lejon lejen e ndërtimit dhe arketohet për çdo rast për llogari të bashkisë që mbulon territorin ku do të kryhet investimi.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

- a. Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

I.5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të

paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabelë 7. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Bashkia Kukes
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m ²	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastres (ASHK) e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe *diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Kukes, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.*

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bëjë rakordimet e të ardhurave me ASHK.

I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura:

Baza e taksës: Është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, tetëmbëdhjetë përqind (18%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Kukes në llogarinë e degës së thesarit.

I.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare:

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, nëçastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Kukes në llogarinë e degës së thesarit.

I.8. Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Tabelë 8. Taksa e tabelës:

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashkia Kukes
I	Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a	<i>deri në 2 m2</i>	leké/m2/vit	0
b	■ <i>mbi 2 m2 deri 10 m2</i>		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	7,000
	•me ndriçim të thjeshtë	leké/m2/vit	11,500
	•elektronike	leké/m2/vit	15 000
c	<i>mbi 10 m2 deri 20 m2</i>		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	5 950
	-me ndriçim të thjeshtë	leké/m2/vit	9 775
	-elektronike	leké/m2/vit	12 750
Ç	<i>mbi 20 m2 deri 40 m2</i>		
	-e thjeshte (pa ndriçim)	leke/m2/vit	3 850
	•me ndriçim të thjeshtë	leké/m2/vit	6 325
	-elektronike	leké/m2/vit	8 250
d	<i>mbi 40 m2</i>		
	•e thjeshtë (pa ndriçim)	leké/m2/vit	2,800

	-me ndriçim te thjeshte	leke/m2/vit	4 600
	•elektronike	leké/m2/vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	-Tabela identifikuese	leké/m2/vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		
	•e thjeshtë (me/pa ndriçim)	leké/m2/vit	13 500
	-Elektronike	leké/m2/vit	27 000
IV.	Tabela ne funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, eti.		
	-té té gjitha llojeve dhe përmasave	leké/m2/ditë	1,000

SQARIM: Për të gjitha tabelat për qëllime identifikimi apo reklamimi të cilat ndodhen jashtë territorit të objektit ku zhvillohet aktiviteti, subjekti paraqet kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë përkatëse, e cila pasi shqyrton kërkesën e subjektit për leje, vendos për dhënien e saj ose jo. Në lejen e lëshuar detyrimisht përcaktohen vendi i ndodhjes, lloji i tabelës, përmasat etj .

Një kopje e lejes së lëshuar dorëzohet në Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave. Kjo e fundit përlllogarit dhe ndjek arkëtimin e taksës së reklamës/tabelës për vitin kalendarik nga muaji korent i vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

I.9. Taksa te perkohshme:

Per linjat ajrore dhe nentokesore (telefoni, energji elektrike dhe internet)

Baza e takses per linjat ajrore dhe nentokesore eshte gjatesia linerare per km e linjave ajrore dhe nentokesore e cila vihet ne shrytezim nga subjektet per qellim biznesi.

Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) dhe (gjatësin për ml ne zonat urbane) me nivelin tregues të saj.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Kukes:

- Për linjat nentokësore: 6.000 lekë/km/vit
- Për linjat ajrore: 10.000 lekë/km/vit
- Takse per perdorimin e rrjetit infrastrukturor kabllor nentoksore 60 lekë/ml/vit
- Takse per perdorimin e rrjetit infrastrukturor kabllor mbitoksore 40 lekë/ml/vit

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së përkohshme për linjat ajrore dhe nentokësore është Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave pranë Bashkisë Kukes.

Kapitulli II: Tarifat Vendore

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agentët tatimorë.

II.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave:

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Kukes dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabela 9: Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet per vitin 2025.

Nr.	Kategoritë: FAMILJARET	Niveli i Tarifës
		Lekë/vit
I.1	Njësia Administrative Kukes	700
I.2	Njësitë e tjera Administrative (50%)	
1.	Njesia administrative Shishtavec.	350
2.	Njesia administrative Bicaç.	350
3.	Njesia administrative Ujmisht	350
4.	Njesia administrative Arren	350
5.	Njesia administrative Terthore	350
6.	Njesia administrative Zapod	350
7.	Njesia administrative Gryke-Çaje	350
8.	Njesia administrative Malzi	350
9.	Njesia administrative Kalis	350
10.	Njesia administrative Surroj	350
11.	Njesia administrative Kolsh	350
12.	Njesia administrative Bushtrice	350
13.	Njesia administrative Shtiqen	350
14.	Njesia administrative Topojan	350

Lehtesimet:

- a. Per familjet ne qytet qe trajtohen me ndihme ekonomike masa e tarifes eshte 500 leke/vit
- b. Per familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike ne fshat masa e tarifes eshte 250 leke/vit.

Tabela 10: Tarifë pastrimi për institucione për vitin 2025.

II	Tarifë pastrimi për institucione	Njësia	Tarifa
	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, sportive, etj.	lekë/vit/njësi	200 lek/m2/vit
	Per institucionet te cilat nuk kane paraqitur dokumenta pronesie prane zyrave te Taksave dhe Tarifa Vendore		100.000lek /vit

Tabela 11: Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset për vitin 2025.

III	BIZNESI	Biznes i vogël	Biznes i madh
III. 1	Njësi tregtare dhe Shërbimi në Njësinë Administrative Kukes	7,000	80,000
III. 2	Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësitë e tjera Administrative		
1	Njesia administrative Shishtavec.	7,000	80,000
2	Njesia administrative Bicaç.	7,000	80,000
3	Njesia administrative Ujmisht	7,000	80,000
4	Njesia administrative Arren	7,000	80,000
5	Njesia administrative Terthore	7,000	80,000
6	Njesia administrative Zapod	7,000	80,000
7	Njesia administrative Gryke-Çaje	7,000	80,000
8	Njesia administrative Malzi	7,000	80,000
9	Njesia administrative Kalis	7,000	80,000

10	Njesia administrative Surroj	7,000	80,000
11	Njesia administrative Kolsh	7,000	80,000
12	Njesia administrative Bushtrice	7,000	80,000
13	Njesia administrative Shtiqen	7,000	80,000
14	Njesia administrative Topojan	7,000	80,000
III. 3	Njësi tregtare për tregtim karburanti	15,000	80,000
III.4	Njesi prodhimi		80,000
III.4.1	Njësi prodhimi ne Njësinë Administrative Kukes	7,000	80,000
III.4.2	Njësi prodhimi ne Njësite e tjera		80,000
1	Njesia administrative Shishtavec.	7,000	80,000
2	Njesia administrative Bicaj.	7,000	80,000
3	Njesia administrative Ujmisht	7,000	80,000
4	Njesia administrative Arren	7,000	80,000
5	Njesia administrative Terthore	7,000	80,000
6	Njesia administrative Zapod	7,000	80,000
7	Njesia administrative Gryke-Çaje	7,000	80,000
8	Njesia administrative Malzi	7,000	80,000
9	Njesia administrative Kalis	7,000	80,000
10	Njesia administrative Surroj	7,000	80,000
11	Njesia administrative Kolsh	7,000	80,000
12	Njesia administrative Bushtrice	7,000	80,000
13	Njesia administrative Shtiqen	7,000	80,000
14	Njesia administrative Topojan	7,000	80,000

III. 5	Subjekte transporti	7,000	80,000
III. 6	Subjektet e ndërtimit	7,000	80,000
III. 7	Subjekte qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne fushen e perpunimit te mineraleve, fabrike asfalto-betoni etj.		150,000
III. 8	Subjekte përp.inerte, gurë e të ngjashme	7,000	80,000
III. 9	Subjektimi tregtimi, beton, inerte, gurë e të ngjashme	7,000	80,000
III. 10	Subjekte qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne fushen e perpunimit te drurit, te prodhimit te mobiljeve, te punimeve te duraluminit, te metalit, te mermerit, te prodhimit te materialeve inerte te ndertimit, prodhimit te granileve etj.	7,000	80,000
III. 11	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar		
	Institucione Administrative Publike		10,000
	Organizata të tjera jofitimprurëse		10,000
III. 12	Profesione të lira		
	Avokatet,noteret, farmaci,mjeke, laborant,stomatolog, ekonomist kontabel te miratuar,ekspert kontabel te autorizuar, mesuesit, veterineret, agronom,botues, inxhiner, arkitekt, projektuesit etj.	7,000	80,000
III. 13	Ambulant		
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	1,000	

Subjekte te prodhimit te energjise dhe nxjerrjes mineraleve		
III.14	Per te gjithë subjektet prodhuese te energjise elektrike	150.000 leke per çdo H/C
III.15	Per te gjithë subjektet nxjerrëse dhe perpunuese te mineralit.	150.000 leke per çdo leje minerare
III.16	Per subjektet e Ndertimit, Seli Administrative	7,000 biznesi vogel 80,000 biznesi madh

III.17	Per çdo automjet transportit te mallrave dhe pasagjereve	5,000
---------------	--	-------

Procedura e vjeljes:

- Struktura për vjeljen e kesaj tarife është Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ne bashkëpunim me Shoqeria e Ujesjellës-Kanalizimeve Sh.a Kukes,Drejtoritë e tjera si dhe njesite administrative.**

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor.

Detyrimi paguhet brenda datës 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

“Subjekte Ndërtimi”

Për “Subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit”, llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Kukes të kërkesës për leje shfrytëzimi. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Kukes vetëm pasi të kenë paguar detyrimet përkatëse për selinë administrative dhe për “çdo kantier ndërtimi”, para zbardhjes së lejes së ndërtimit si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

Për të gjitha kategoritë:

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Përjashtime për kategoritë e ndryshme:

Tabelë 12. Përjashtimet për individët dhe familjet nga tarifa e pastrimit

	Përjashtime	Niveli
1	Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)	0 leke
2	Përfituesit e ndihmës ekonomike	50% te vleres
3	Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes); Kryefamiljarët gra me mbi dy fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç);	50% të vlerës

- a) Nënkatëgoritë 1-3 përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së pastrimit (vetëm në rastet kur janë k/familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç) dhe nuk ushtrojnë aktivitet ekonomik. Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së taksave dhe Tarifave Vendore dëshminë e gjëndjes së tyre dhe më konkretisht:

- Çertifikatën familjare, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Listat e përfituesve administrohen nga Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, që rivlerëson detyrimin dhe sipas rastit, dërgon informacionin për zbatim tek agjenti tatimor.

- Në kategorinë III “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.
- Përjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Kukes; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Kukes, Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Kukes; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës:

Për Kategoria I: Struktura e ngarkuar është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kukes.

Inspektorët i taksave të popullsisë në NJA-të administrative në bashkepunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave vendore.

Kategoria III: “Biznesi”, Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, Drejtoria e te Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave Bashkia Kukes.

II.2 Tarifa e ndriçimit

Përkufizimi: Tarifa e ndriçimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Kukes.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 13. Tarifë ndriçimi për familje për vitin 2025

	Tarifë ndriçimi për familje	Njësia	Tarifa
I	Familje NjA Kukes , (për familje)	lekë/vit/familje	200
	Familje NjA te tjera , (për familje)	lekë/vit/familje	200
	Ambulantet		200

Tabelë 14. Tarifë ndriçimi për institucione për vitin 2025.

	Tarifë ndriçimi për institucione	Njësia	Tarifa
II	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj. dhe ojf.	lekë/vit/njësi	5000

Tabelë 15. Tarifë ndriçimi për biznesin për vitin 2025.

	Tarifë ndriçimi për biznesin	Njësia	Tarifa
III	Biznesi		
III.1	Subjekte tregtare dhe shërbimi		
	Per subjekte biznes i vogel	lekë/vit/njësi	2.000
	Biznes i Madh	lekë/vit/njësi	5.000
III.2	Pikë Karburanti	lekë/vit/njësi	5.000
III.3	Profesione të lira	lekë/vit/njësi	2,000
III.4	Subjekte prodhimi, përpunimi, etj.		
	Biznes i Vogël	lekë/vit/njësi	2,000
	Biznes i Madh	lekë/vit/njësi	5.000
III.5	Biznes transporti	lekë/vit/njësi	2,000
III.6	Subjekte ndërtimi	lekë/vit/njësi	5.000
III.7	Subjekte biznes i madh me disa aktivitete ne nje godine me shume dhoma ose shume kate	leke/vit/njesi	10.000

Kategoria I. “Familjarët”: Detyrimi per taksen e ndricimit eshte vjetor. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës se ndriçimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoritë II, III: Detyrimi paguhet brenda datës 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

